

-40-

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

VENDIM

Nr 5 Dt. 05. 09. 2012

MIRATIMIN NE PARIM

**“MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJOR PERROI LISHANIT,
KOMUNA MAQELLARE, DIBER
PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA
SUBJEKTI “ SUFA 1 ” sh.p.k.
HEC LISHANIT”.**

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga subjekti “ Sufa 1 ” sh.p.k. per perdorimin e burimit uJOR Perroi Lishanit, Komuna Maqellar, Diber, per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin- Bune dhe udhezimit te Perbashket ne mes te M.M.P.AU. me M.E.T.E., rezulton se propozimi i mesiperme nuk ka te beje me projekte per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperme vepra e marrjes te ujit, do te ndertohet ne perroin e Lishanit, ne kuoten + 630 m. Ndertesa e centralit do ndertohet , ne kuoten + 380 m. Prurja mesatare ne vepren e marrjes eshte $Q = 0.2 \text{ m}^3/\text{sek}$. Subjekti kerkon te shfrytetoje nje prurje $Q = 0.24 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Subjekti nuk do pengoje perdorimin e ujit per nevojat e komunitetit.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 “ PER KONCESIONET” dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 3, kreu IV, i V.K.M. nr. 87 dt. 16.01.2008, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M. “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Sekretari

Muhamet MUÇA

Kryetare

Voltana ADEMI



MORA NJE KOPJE

08/10/2012 BUREN QORAK